



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 294/prot.  
2

Laç, më 30.01.2024

VENDIM

Nr. 02, datë 25.01.2024

**“PËR MIRATIMIN E KALIMIT ME SIPËRMARRJE TË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT, GRUMBULLIMIT DHE DEPOZITIMIT TË MBETJEVE URBANE DHE TË NGURTA, TË SHËRBIMIT TË MIRËMBAJTJES SË HAPËSIRAVE PUBLIKE DHE TË VARREZAVE ME AFAT 5-VJEÇAR PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE LAÇ, BASHKIA KURBIN”.**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit nr.8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, të ligjit nr.10 463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar, të ligjit nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” të ndryshuar, të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ligjit nr.91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 31.5.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 21.06.1994 “Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave”, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.473, datë 03.10.1994 “Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike të funeralit, mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta, dekorit dhe varrezave publike të dëshmoreve”, të ndryshuar pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI;**

1. Miratimin e kalimit me sipërmarrje të shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve urbane dhe të ngurta, të shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave publike dhe të varrezave për Njësinë Administrative Laç, Bashkia Kurbin”.
2. Miratimin e kohëzgjatjes së këtyre shërbimeve për një periudhë 5-vjeçare.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

>Prefekti i Qarkut Lezhë

>Drejtoria e Financave

>Drejtoria e Sherbimeve Publike

>Drejtoria Juridike

>Arkivi

**Sekretari i Këshillit**

**Arber Leka**



**Kryetare e Këshillit**

**Edlira Dreshi**

